



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja **d**) e Ligjit nr. 03/L – 40, për Vetëqeverisje Lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15, qershor 2008), të dispozitave të nenit 34, paragrafi 34.1, shkronja **d**) e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 – 391, dt. 25.2.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhje e mbajtur më 27.2.2026, merr këtë:

V E N D I M
P Ë R
FORMIMIN E GRUPIT PUNUES PËR HARTIMIN E PLANIT VJETOR TË PUNËS
SË KUVENDIT PËR VITIN 2026

I. Miratohet Vendimi për formimin e grupit punues për hartimin e planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2026.

II. Grupi punues nga pika I e këtij vendimi, është në këtë përbërje:

1. Fehmi Kupina - kryesues i Kuvendit;
2. Rifadije Sopi – LDK (anëtare);
3. Arbnora Ajeti – PDK (anëtare);
4. Çlirim Gërbeshi - LVV (anëtar);
5. Erblina Tahiraj – AAK (anëtare);
6. Teuta Kadiu Xhinolli - Lidhja e Prishtinës (anëtare);
7. Endrit Zabërgja – NISMA, (anëtar);
8. Besa Shahini – PSD, (anëtare);
9. Jeton Mehmeti – lista GUXO, (anëtar);
10. Sokol Havolli - përfaqësues i ekzekutivit (anëtar);
11. Luljeta Selimi - përfaqësuese e Sektorit për punë të Kuvendit (anëtare);
12. Diellon Gjonbalaj - përfaqësues i Zyrës ligjore (anëtar).

III. Detyrë e grupit punues të cekur në pikën II të këtij vendimi, është që në pajtim me kompetencat dhe përgjegjësitë që ka Kuvendi i komunës me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, dispozitat e ligjeve tjera - pjesën me kompetencë të komunës, aktet nënligjore dhe Statutin e komunës, të hartojë planin vjetor të punës së Kuvendit të komunës për vitin 2026. Pas hartimit të planit final, grupi punues do ta prezantojë para Kuvendit të komunës për miratim.

IV. Ky vendim hyn në fuqi 30 (tridhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT
01-020/04-31217/26, më 2.3.2026

